



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 20, Datë 04.02.2022

MBI

**ECURINË E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE PËR VITIN
2021, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE
STRATEGJIKË TË ERE PËR PERIUdhËN 2021 – 2023 SI DHE PËRDITËSIMIN E
PLANIT TE MASAVE PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË ERE-S
PËR VITET 2022 – 2023**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 179/4 prot., datë 01.02.2022 “Mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 e në vijim, sipas planit të masave për zbatimin e objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023 si dhe miratimin e planit të masave për objektivat strategjik të ERE-s të rishikuar për vitet 2022-2023”,

Konstatoi se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 74, datë 12.03.2021 u miratuan Objektivat Strategjikë të ERE-s për vitet 2021-2023. Ky dokument vendos objektivat strategjike që ERE synon të realizojë brenda një periudhe 3-vjeçare, me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
- Në vijim, bordi i ERE-s me vendimin nr. 96, datë 06.04.2021, vendosi miratimin e Kalendarit të Masave për zbatimin e Objektivave Strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023.
- Kalendarit i masave për zbatimin e Objektivave Strategjike të ERE ka përcaktuar në mënyrë të qartë objektivat, detyrat, afatet si dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara me detyrimin e zbatimit dhe ndjekjes së vazhdueshme të objektivave 3 - vjeçare të ERE-s.
- Në zbatim të parashikimeve të Kalendarit të Masave si dhe pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 06.04.2021, Drejtoritë Teknikë të ERE-s kanë paraqitur analizat e tyre me detyrat e kryera për zbatimin e targetave të vendosura për vitin 2021.

- Rezulton se strukturat e ERE-s kanë përmbushur tërësisht disa nga detyrat e lidhura me targetat e vendosur për vitin 2021 si dhe janë në vijim të punës për përmbushjen e disa prej targetave të vitit 2021 e në vazhdim.
- Duke qënë se një pjesë e detyrave lidhen jo vetëm me punën e bërë nga ERE në kuadër të përmbushjes së targetave, por edhe me ndërveprimin me institucione të tjera, ka lindur nevoja e përditësimit të Kalendarit të Masave me qëllim vijim e punës dhe adresimin e realizimit të detyrave për vitet në vazhdim.
- Kalendarit i Masave i rishikuar, rivendos në afat, disa nga detyrat dhe targetat e planit të masave të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96/2021, me qëllim adresimin e tyre brenda vitit 2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kalendarin e përditësuar të masave të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për ndjekjen e zbatimit të objektivave strategjike të ERE për periudhën 2022-2023 (Bashkëlidhur tabela nr.1).
2. Kalendarit i përditësuar i masave, i miratuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë objekt vlerësimi dhe rishikimi jo më vonë se data 30 Janar i çdo viti kalendarik, deri në implementimin e plotë të tij.
3. Ngarkohet çdo strukturë e ERE-s për zbatimin e këtij vendimi.
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë çdo strukturë të ERE-s për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tabela nr. 1 KALENDARI I RISHIKUAR I OBJEKTIVAVE PËR VITET 2022 - 2023

Nr.	Objektivi	Detyrat	Struktura përgjegjëse	Afati
1)	Ndërgjegjësimi i konsumatorit për t'u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, kuptimin e drejtë të mekanizmave të tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin e energjisë elektrike.	Realizimi i rubrikës informative mbi ofertat e tregut të furnizimit me energji elektrike (price comparison tool).	DMKPS/ DMT/DEF	– 2022 vijim -
		Përgatitja e broshurave informative për konsumatorin.	DMKPS/DEF	– 2022 vijim -
		Ndjekja e nivelit të interesit në vend, mbi vetë prodhimin e energjisë.	DMKPS/ DMT	– 2022 vijim -
2)	Incentivimi i teknologjisë së llëvizjes së makinave elektrike.	Komunikim publik mbi interesin për teknologjinë.	DMKPS/DTÇ	– 2022 vijim -
		Trajnimi i stafit të ERE mbi këtë teknologji të re.	DTÇ/DMKPS /DJZM	– 2022 vijim -
3)	Sensibilizimi i konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike.	Njohje e thelluar e legjislacionit ndërkombëtar.	DMKPS	– 2022 vijim -
		Sensibilizim i konsumatorit mbi përdorimin eficient të energjisë elektrike.	DMKPS	– 2022 vijim -
4)	Dhënia zë konsumatorit.	Vënia në funksion e numrit të gjelbër për informimin e konsumatorit.	DMKPS/DEF	– 2022
		Organizim trajnimi për grupe interesi me objekt “informimin mbi të drejtat e konsumatorit”.	DMKPS	– 2022 vijim -
		Organizimi i tryezave të bashkëpunimit me zyrat e konsumatorit në bashkitë e vendit si dhe organizatat e krijuara për këtë qëllim.	DMKPS	– 2022 vijim -

5)	Mbrojtja e Klientëve në nevojë	Konsultim me Ministritë përgjegjëse dhe propozime konkrete për përcaktimin e kriterëve për marrjen e statusit me VKM.	DJZM	– 2022 vijim -
		Mbikëqyrjen e shërbimit të FSHU për kushtet e ndërprerjes për klientët në nevojë.	DMKPS/DMT	– 2022 vijim -
		Përgatitjen e takimeve informative me përfaqësues të shoqatave për mbrojtjen e kategorisë, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet.	DMKPS	– 2022 vijim -
		Kryerja e një studimi lidhur me politikat më të mira rregulluese për mbrojtjen e klientëve në nevojë në vendet e BE-së.	DMKPS/DJZ M	– 2022 -
6)	Zhvillimi i një Portali të Konsumatorit.	Krijimi i portalit të konsumatorit.	DMKPS/DEF	– 2022 -
		Përditësimi periodik i statusit të ankesave të konsumatorit të adresuara nga ERE për gjurmimin e ankesës në faqen e ERE (me kod aksesit unik).	DMKPS/DEF	– 2022 vijim -
7)	Përcaktimi i treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj Klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim.	Përditësimi dhe mbikëqyrja e standardeve të cilësisë së shërbimit.	DMT/DMKPS	– 2022 vijim -
		Monitorime për FSHU dhe furnizuesit në treg të lirë.	DMT	– 2022 vijim -
		Mbikëqyrja e nivelit të informacionit të konsumatorit mbi shërbimin.	DMKPS	– 2022 vijim -

8)	Zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi dhe hapja e tregut.	Analize e plotë e dhe rishikim i problematikave të konstatuara lidhur me metodologjitë e tarifave dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim në bashkëpunim me insitucione ndërkombëtare.	DTÇ/DJZM	– 2022-vijim
		Realizimi i një studimi në mënyrë që te vlerësohen mundësitë që çojnë në uljen e kostove për konsumatorët.	DTÇ/DMT	– 2022
9)	Analizë e tregut për gaz natyror.	Identifikimi i nevojës dhe kërkesave për gaz. Analizë studimore mbi përdoruesit e gazit në vendet e rajonit dhe pritshmërinë për tregun shqiptar.	DGN/DJZM	– 2022
		Studimi i skenarëve për të mundësuar furnizimin me gaz të konsumatorit shqiptar, familjar ose jo familjar.	DGN/DJZM	– 2022
		Studimi i Politikave të çmimeve dhe tarifave.	DGN/DJZM/DTÇ	– 2022
		Vlerësimi i rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri, dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit	DGN	– 2022
10)	Integrimi Rajonal.	Monitorim i zhvillimit të vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator të tregut rajonal.	DMT/DJZM	– 2022-vijim
		Miratimi i procedurave të përbashkëta dhe efikase të vendimmarrjes, që do të ndihmojnë në krijimin e	DMT/DJZM	– 2022-vijim

		mundshëm dhe të duhur të Bursës së energjisë elektrike.		
		Kontrollin dhe perditësimin e legjislacionit në fuqi nëse ka pengesa ligjore në procesin e bashkimit të tregut.	DJZM	– 2022
		Nominimin e NEMO-s për operimin e të dy tregjeve në përputhje me kushtet e nominimit, si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.	DMT/DJZM	– 2022
11)	Forcimi i aksesit në informacion për ecurinë korrekte të proceseve të tregut.	Mbikëqyrje e nivelit të implementimit të Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët si dhe shtrirjen e saj dhe në sektorin e gazit natyror.	DMT/DEF	– 2022 vijim -
		Monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, veçanërisht në zbatimin e Rregullores Evropiane REMIT. Rishikimi i zbatimit të rregullave për integritetin dhe transparencën e tregut.	DMT/DJZM	– 2022 vijim -
12)	Funksionimi i proceseve të tregut.	Analizimi i të dhënave lidhur me detyrimet e raportimit, metodat dhe kohën e vënies së tyre në dispozicion, përdorimi i të dhënave për palët e interesuara dhe në veçanti për pjesëmarrësit e tregut.	DMT	– 2022
13)	Realizimi i bashkimit të tregjeve Shqipëri - Kosove.	Identifikimi se cilat pjesë të CACM mund të transpozohen në kornizën ligjore aktuale.	DMT/DJZM	– 2022 vijim -

		Kontrolli nëse ka pengesa ligjore në legjislacionin kombëtar që pengojnë ose vonojnë bashkimin e tregjeve.	DMT/DJZM	– 2022 vijim	-
		Të punohet në drejtim të zgjerimit të integritimit duke ftuar rregullatorët e tjerë të Ballkanit për t'u bashkuar në projektet në kuadër të WB6.	DMT/DJZM	– 2022 vijim	-
14)	Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë administrative.	Përfshirja e palëve të interesuara në përcaktimin e strategjive, politikave rregullatore.	DJZM	– 2022 vijim	-
		Ngritjen e strukturave konsultative të përhershme të tilla si komisione të përbashkëta të palëve të interesit që do t'i shërbejnë vendimmarrjes. Miratimi i udhëzimit/rregullores së ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të përhershëm.	DJZM	– 2022	
		Publikimi i vendimeve, relacioneve të akteve rregullatore dhe aplikimeve.	DJZM	– Periodik	
		Verifikimin ex post i ndikimit të akteve rregullatore.	DJZM	– 2022 vijim	-
		Studim i praktikave më të mira për vlerësimin e efekteve të rregullimit me mbështetje nga ekspertë akademikë dhe ekspertë të tjerë me përvojë në fushë.	DJZM	– 2022 vijim	-
		Shqyrtimi nëse tregu i energjisë elektrike po punon për të siguruar transaksione efikase të tregtisë.	DJZM/ DMT	– 2022 vijim	-

	Angazhimi me operatorët mbi administrimin e kodeve të rrjetit.	DJZM/ DMT	– 2022 vijim	-
	Angazhimi me aktorët brenda vendit dhe organizmat evropianë apo dhe me homologe për plotësimin e kuadrit rregullator.	DJZM	– 2022 vijim	-
	Bashkëpunim ndërinstytucional dhe me institucionet evropiane të lidhura me mekanizma që promovojnë një treg eficient dhe të qëndrueshëm.	DJZM/DMT	– 2022 vijim	-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 20, Datë 04.02.2022

MBI

**ECURINË E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE PËR VITIN
2021, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE
STRATEGJIKË TË ERE PËR PERIUDHËN 2021 – 2023 SI DHE PËRDITËSIMIN E
PLANIT TE MASAVE PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË ERE-S
PËR VITET 2022 – 2023**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Erjola Sadushi

Maksim Shuli

Raimonda Islamaj
